

GABIMET MË TË SHPESHTA DREJTSHKRIMORE NËPËR SHKOLLA

Zurijeta SALIU¹

¹Hamburg, Gjermani

²zurijeta_saliu@live.com

Abstrakt

Çdo njeri është mjeshtër i ndonjë pune dhe çdokush merret me një punë të caktuar. Edhe ne si gjuhëtar merremi me gjuhën, rëndësinë e saj, bukurinë e saj dhe më e rëndësishmja ruajtjen e saj. Ajo që neve na vret më së shumti janë gabimet. Duam apo nuk duam kur marrim të punojmë diçka, të lexojmë apo edhe rastësisht pa mos i kushtuar vëmendje, janë gabimet të cilat na bien në sy. E jo vetëm që i shohim por disi edhe sikur na e vrasin syrin e na pengojnë. Sikur në një fletë mund të ketë shumë fjalë të shkruara në mënyrë të njëjtë, fjala që është gabim duket më e madhe e më e dukshme, syri shkon gjithmonë aty. E siç thotë populli "Gjuha shkon ku dhemb dhëmbi" edhe neve syri na shkon ku janë gabimet. Ajo që është më e dhimbshme për ne, është kur gjejmë gabime tek nxënësit, tek arsimtarët, tek profesorët, nëpër administrata të shkollave etj. Aty ku fillon edukimi e arsimimi dhe fatkeqësisht fillon me gabime. Prej aty ia fillojmë gabim. Gjoja ne i mësojmë nxënësit, e mësimin ua japim gabim. E nuk bëjmë fjalë për popullin dhe për vendet tjera të punës, derisa nëpër shkolla kemi mangësi të gjuhës shqipe dhe shkruajmë me gabime. Në këtë punim do të shohim gabimet në administrata shkollore dhe një hulumtim i shkurtër i gabimeve që më së shpeshti i bëjnë nxënësit. Shpresojmë që këto mangësi sadopak të zbuten e të përmirësohen.

Fjalët kyçe: *gjuha, shkolla, fjalët, arsimi dhe gabime.*

Gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore nëpër shkolla

Hulumtimi në fjalë ka të bëjë me gabimet drejtshkrimore dhe gramatikore që i hasim nëpër shkolla. Gabimet i gjejmë në çdo vend e në çdo kënd, jo vetëm tek populli, tek njerëzit e thjeshtë, tek nxënësit, studentët apo tek gjuha që përdoret kudo. Ajo që është më e dhimbshme, është që gabimet i gjejmë edhe nëpër shkolla, vendi ku merret dituria dhe ku duhet të luftohet kjo problematikë. E pikërisht edhe këtu gjejmë gabime.

Hulumtimin do ta fillojmë me gabimet nëpër administratat e shkollave.

Gjatë hulumtimit kam hasur disa gabime drejtshkrimore dhe gramatikore të cilat do ti cekim më poshtë:

thirje - thirrje

regult - rregullt

ser - sërë

asë - as te

kan - kanë

bënë - bën

duhët - duhet

të vijn - të vijnë
 qendrojnë - qëndrojnë
 qellim - qëllim
 penges - pengesë
 përditëshme - përditshme
 vendmbanim - vendbanim etj.

Gabimet në të shpeshta janë:

- në vend të shkronjës „rr“ është përdorur shkronja “r”;
- mungesa e shkronjës „ë“;
- vendosja e shkronjës „ë“ në vende të gabuara etj.



Hasim edhe disa gabime të tjera. P.sh. „Të Drejtat dhe Obligimet e nxënësve“, ku janë të shënuara me shkronjë të madhe „Drejtat“ dhe „Obligimet“, që duhet të jetë „Të drejtat dhe obligimet e nxënësve“ etj.

Kemi edhe gabime në fjali, mospërputhja në numër dhe gjini.

P. sh. „të hyn persona fizik e aq më pak të qëndoj aty“, në vend të „të hyjnë persona fizik dhe aq më pak të qëndrojnë aty“, „prindërit nuk bënë“, në vend të „prindërit nuk bëjnë“ etj.

Gjithashtu kemi edhe mungesa të shenjave të pikësimit, mungesa e presjeve në fjali dhe mungesa e pikave në fund të fjalive.

Sa për ilustrim do të shohim disa dokumente të gjetura me këto gabime:



Deri te: _____ Nr. Arkiv 0302- _____
 Di: _____

LËNDA: THIRJE PËR BISEDË

1. Enderuari, zotëri/ zonjë _____

me vendimbanim _____
 Kujdestari i kalës nga klasa _____ në SHMK _____
 ftojë në bisedë konsultative për shkak të mungesës së paarsyeshme nga p
 mesimor të djalit/vajzës tuaj _____ përkat
 për shkak të mungesave pa arsye _____

Suarim (ndonjë problem tjetër që ka nxënësi) _____

Biseda do të zhvillohet në hapësirat e SHMK _____ me c
 _____ ora _____

**Prezenca e Juaj është e obligueshme me qëllim të tejkalimit të problemit
 lartpërmendur.**

_____ 201 _____ Kujdestar klase _____

Gabimet që na shoqërojnë kudo e çdoherë janë: mësimnxënije - mësimnxëni, vrejte - vërejtje, drejtorin - drejtorinë, orao i plot - orar i plotë, padrejtësin - padrejtësinë etj.

Këto ishin disa gabime sa u përket administratave të shkollave, duke i lënë anash gabimet teknike që janë shumë e më shumë.

Gabimet në ditarë

Edhe pse tani jemi në një kohë ku teknologjia ka kaluar çdo cep, gabimet nuk na lënë rehat, ato na ndjekin e na shoqërojnë kudo. Meqenëse ditarët e dorës gati se në shumë shkolla nuk përdoren dhe janë zëvendësuar me ditarët elektronik, prapëseprap gabimet i marrim me vete kudo.

Gabimet më të shpeshta nëpër ditarë janë:

informatik – informatikë,

matematik – matematikë,

fizik - fizikë etj.

Si çdo herë edhe këtë herë kemi mungesë të shkronjës „ë“.

Do të shohim edhe disa përmbajtje të orëvë mësimore:

„Mjetet dhe gabimet gjat matjeve“ - gjatë,

„Test i përgaditur në fletë“ - përgatitur,

„Korigjimi i testit kontrollues“ - korigjimi,

„Mardhëniet në shoqëri“ - marrëdhëniet etj.

Ndoshta për të tjerët nuk është diçka e madhe, e as fundi i botës, por këto gabime për ne si gjuhëtar janë të pafalshme, e sidomos kur bëhet fjalë për njerëz të shkolluar. Një njeri që ka mbaruar një fakultet në çfarëdo fushe, i bart me vete gabimet gjuhësore dhe shpërndan dije tek e ardhmja e popullit, me të vërtetë është mëkat.

Thënia „Nëse do ta shkatërosh një popull, fillo nga arsimit“. E pra në këtë rrugë jemi edhe ne, duke dëshiruar ti ngrisim vlerat e arsimit, i ulim ato me gabimet e përditshme që përcjellim tek gjenerata e reja.

Gabimet më të shpeshta tek nxënësit

Kjo nuk është rastësi, derisa gabojnë profesorë e njerëz akademik, është normale që ato gabime do të shfaqen edhe te nxënësit.

Hulumtimi është bërë më 50 nxënës, që kanë shkruajtur një ese me temë të njëjtë.

Fjala e përdorur	Fjala e saktë	Sa herë
Mar - marë	marr	8
rrini	rini	2
merriton	meriton	2
egziston	ekziston	4
karike	karrige	1
kan	kanë	1
gjith	gjithë	7
jan	janë	7
bot	botë	3
është	ështëë	9
gjall	gjallë	3
thot	thotë	6
fjal	fjalë	4
munt	mund	2

Gabimet më të shpeshta i kemi te mungesa e shkronjës „ë“ në fund të fjalës, mungesa e shkronjës „rr“ ose vendosja e saj në vende jo të duhura, zëvendësimi i shkronjës „k“ me shkronjën „g“ dhe anasjelltas etj.

Përfundim

Këto janë vetëm disa gabime të gjetura gjatë këtij hulumtimi, mirëpo ka shumë e më shumë gabime, sigurisht se nëse hulumtojmë më gjatë e më shumë, gjejmë edhe më shumë gabime. Këto gabime do të na shoqërojnë çdo herë nëse në nuk marrim masa paraprake.

- E cilat janë ato masa paraprake?

Edhe pse në shkolla të mësuara gjuha shqipe ka katër orë në javë, ajo nuk është e mjaftueshme, sepse ajo zbehet gjatë studimeve, mungesa e gjuhës shqipe nëpër fakultete sjell deri te këto problematika. Në fakultete të ndryshme kemi dy ose katër semestra gjuhë shqipe dhe mbaron me kaq. Pastaj studenti diplomohet në fusha të ndryshme, merr një titull të caktuar, e më pas edhe një punë të caktuar, por bazat e gjuhës i mungojnë. Është detyrë e universiteteve që të shtojnë lëndën e gjuhës shqipe në më shumë semestra, apo edhe studenti para diplomimit ti nënshtrohet një testi të gjuhës, që e zotëron gjuhën që i ka mbaruar studimet. Dhe e fundit, një profesor para se të punësohet, duhet dhe është në të mirën e të gjithëve, që ti nënshtrohet një provimi të gjuhës, të paktën në aspektin drejtshkrimor dhe gramatikor.

Sa do që të mundohen profesorët, apo mësuesit e gjuhës, për ta rruajtur gjuhën, pa mbështetje nuk ia arrijnë dot. Sepse nëse në një shkollë të mesme orari është më katër orë në javë „Gjuhë dhe letërsi shqipe“ dhe diku mbi njëzet orë lëndë tjera, nëse mësuesit dhe profesorët bëjnë gabime gjuhësore, nxënësit i pranojnë më lehtë gabimet e njëzet orëve, sesa rregullat e katër orëve të gjuhës shqipe.

E mund të thotë matematicienti, fizicenti e të tjerët, se çka na duhet neve gjuha shqipe, nuk është punë e jona. Po është e vërtetë, që nuk është punë e atyre, por për tu dhënë dituri dikujt, të paktën jepja në mënyrë të drejtë. Si me thënë, çka na duhen numrat, me rëndësi janë formulat matematikore, por pa numra nuk kemi formulë e as zgjidhje detyrash. Edhe pa gjuhë nuk mund të kemi teori. Kështu që ato që marrin mbi supë të punojnë në arsim, së pari duhet të jenë të përgatitur mirë në aspektin gjuhësor, e pastaj diturinë e tyre ta përcjellin tek nxënësit, që janë ardhmëria jonë.

Literatura

- [1]. Grup autorësh . (1996). “*Gjuhë shqipe dhe leximi*”, për klasën e gjashtë të shkollave fillore. Prosvetno Dello. Shkup.
- [2]. <https://klankosova.tv/mesuesja-e-gjuhes-shqipe-i-ankohet-komunes-me-plot-gabime-drejtshkrimore-videoç/>
- [3]. <https://prezi.com/25clgzi6sgth/gabimet-drejtshkrimore-ne-mbishkrimet-publike-ne-gjilan/>